



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 90, dt. 22.04.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.04.2016, pasi shqyrtoi projektin “Zhvillimi i rrjetit 20 kV fideri F3 dhe F4 nga n/stacioni 110/20kV, Gjirokastër”, me subjekt aplikues OSHEE, e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti për punimet të shtrirjes së rrjetit elektrik, fiderat F3 dhe F4 në lagjen Dunavat dhe në lagjen Meçite. Punimet në kalldrëme të kryhen sipas specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi restaurator, bashkangjitur projektit.
2. Punimet e restaurimit të kalldrëmit në këtë zonë duhet të realizohen nga një shoqëri e pajisur me licensë në fushën e restaurimeve.
3. Punimet të mbikqyren nga specialistët e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastër.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI